



DEKLARATË

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e të Fëmijës reagon me shqetësim për mënyrën dhe përmasat me të cilën është trajtuar dhe po vazhdon të trajtohet rasti i ngjarjes së ndodhur në Kavajë.

Menjëherë pas marrjes dijeni për rastin, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, me cilësinë e autoritetit kompetent për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, bazuar në nenin 41 të ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ka ngritur Grupin e Monitorimit, që ka realizuar disa vizita në terren për vlerësimin e situatës dhe ofrimin e mbështetjes për menaxhimin e rastit.

Gjatë kësaj periudhe, Agjencia ka nxitur realizimin e takimit të Grupit Teknik Ndërsektorial, me drejtues të institucioneve vendore dhe profesionistë. Ka siguruar shërbimin shëndetësor dhe psiko-terapeutik për vajzën, si dhe ka mbështetur ndërhyrjet institucionale me fëmijët, prindërit, mësuesit, nëpërmjet asistencës së ekspertëve të specializuar për çështjet e abuzimit.

Që prej një jave kur rasti u bë publik, vajza dhe fëmijët e tjerë, autorë të veprës penale, janë vënë në epiqendrën e opinionit publik. Gjithë opinioni është tronditur dhe ka reaguuar. Kudo në media, portale online, parlament, komunitetin ku ka ndodhur ngjarja e më gjërë, një valë debati mbi ngjarjen, e veshur me opinione personale, konstatime emocionale, detaje sensitive kanë shkaktuar një situatë shumë të rëndë për fëmijët dhe familjarët e përfshirë në ngjarje.

Agjencia ka qenë pranë familjes së vajzës në Kavajë, pranë fëmijëve të shkollës, prindërve të tyre dhe është përballur me shqetësimin e madh që jehona e debatit ka shkaktuar.

Publikimi i fakteve të pakonfirmuara, detajeve intime, opinioneve apo gjykime mbi fëmijët e përfshirë, kanë prekur thellë, cënuar, përgojuar dhe dëmtuar fëmijët dhe familjet e tyre.

Bëjmë me dije se bazuar në Ligjin 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” mbrojtja dhe respektimi i jetës private, familjare dhe mbrojtja nga cenimi i paligjshëm i moralit dhe i dinjitetit, është një nga të drejtat e fëmijës, që duhet të respektohet në çdo rast. Privatësia e fëmijëve të përfshirë në ngjarje, duhet të respektohet në të gjitha fazat e procedurave gjyqësore duke përfshirë edhe publikimin e tyre në media.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, me qëllim mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës, i bën thirrje medias, politikanëve dhe opinionit publik, të shmangin debatet, retorikën fajësuese ndaj fëmijëve dhe familjeve të tyre, që shkaktojnë ritraumatizim dhe e bëjnë më të vështirë punën për rehabilitimin e fëmijëve. Është shumë e rëndësishme që gjithë shoqëria të kuptojë efektet negative, që po shkakton situata e krijuar, në shëndetin dhe zhvillimin emocional të fëmijëve

Fenomeni i abuzimit seksual të fëmijëve është një fenomen shumë shqetësues dhe ka nevojë për sensibilizim dhe reagim, por tashmë ky diskutim duhet të zhvillohet i shkëputur nga ngjarja aktuale.

Është e domosdoshme që të ndërjegjësohemi dhe të marrin masa për të mbajtur fëmijët fizikisht dhe emocionalisht të sigurtë.

#Fëmijët të parët